

**INSTITUTI I STUDIMEVE PEDAGOGJIKE**

**PROGRAMI I LËNDËS  
SË EDUKIMIT MUZIKOR**

**Klasa I**

**CIKLI FILLOR I SHKOLLËS 9-VJEÇARE**

**TIRANË, 2003**

## Hyrje

Elementet e para të edukatës muzikore fëmija fillon i merr në familje që në moshë të hershme. Më pas, në arsimin parashkollor, përmes këngëve të thjeshta, imitimeve të ritmeve apo të tingujve të ndryshëm nga jeta e përditshme dhe lojërave muzikore, kalohet në një punë të organizuar për t'i pajisur fëmijët me elemente muzikore dhe për t'i përjetuar ato. Të gjithë këto elemente muzikore, të cilat ndërthuren gjatë të kënduarit, të dëgjuarit, të shprehurit të muzikës, janë forma fillestare të të kuptuarit të saj, të cilat do të vijojnë të zhvillohen më tej në arsimin fillor dhe më tej.

Në klasën e parë të ciklit fillor elementet bazë të muzikës jepen në një mënyrë shumë të thjeshtë, duke i marrë dhe duke i konkretizuar ato kryesisht nga jeta e përditshme, nga dëgjimet e thjeshta muzikore, nga të kënduarit e vazhdueshëm, nëpërmjet këngëve për fëmijë apo këngëve popullore të thjeshta. Në këtë mënyrë nxënësit do të aftësohen për të praktikuar ato elemente muzikore, duke përdorur një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme për këtë moshë.

Në klasën e parë njohuritë dhe elementet e para muzikore merren dhe mësohen jo më në mënyrë intuitive, por duke i gjetur në mjedisin e tyre ose në klasë dhe duke i zbatuar ato te këngët, lojërat, dëgjimet e ndryshme dhe më pas duke krijuar vetë me to. Njohuritë muzikore, të cilat nxënësi do t'i njohë, do t'i dallojë dhe do t'i përdorë gjatë procesit mësimor, janë: 1) *shprehitë e të kënduarit* ku ai do të fillojë të bëjë shprehje në çdo orë që këndon, *shqiptimi i saktë* i fjalëve të këngës etj; 2) *ritmi*; 3) *vetitë e tingullit* (gjatësia, lartësia, ngjyra, timbri, tempa etj.); 4) *njohja e veglave ritmike* me goditje dhe përdorimi i tyre gjatë këndimit apo lojërave muzikore; 5) *përjetimi i muzikës dhe shprehja e saj*, duke përdorur mjete të arteve të tjera dhe një terminologji që përputhet me këtë moshë. Pra, gjatë procesit të të mësuarit njohuritë muzikore janë të lidhura ngushtë dhe gjejnë zbatim në praktikën muzikore. Kjo do të thotë se të gjitha njohuritë, aftësitë dhe shprehitë e fituara gjatë procesit mësimor realizohen duke u ndërthurur përmes veprimtarive praktike artistike në klasë, shkollë ose në auditore të ndryshme.

## I. SYNIMI

***Mësimi i muzikës në klasën e parë të arsimit të detyruar 9-vjeçar synon t'i aftësojë nxënësit për të përjetuar dhe për t'u shprehur nëpërmjet muzikës.***

Programi synon ***të kultivojë shprehitë fillestare*** për të kënduar, për të dëgjuar, për të luajtur, për të krijuar, si dhe për t'u shprehur duke vlerësuar muzikën.

***Mësimi i muzikës në klasën e parë ka për qëllim që nxënësit:***

- Të këndojnë këngë të thjeshta për fëmijë, si dhe këngë popullore të thjeshta nga krahina e tyre;
- Të këndojnë me intonacion dhe shprehje;
- Të formojnë shprehitë e të kënduarit;
- Të luajnë lojëra muzikore;
- Të shoqërojnë këngët apo lojërat muzikore me mjete të thjeshta ritmike, si: gurë, shkopinj, shuplaka etj;
- Të njohin dhe të kuptojnë elementet dhe konceptet muzikore, nëpërmjet shembujve të thjeshtë nga jeta e përditshme dhe muzika që këndojnë dhe dëgjojnë;
- Të gjejnë dhe të kuptojnë ritmin në mjedisin e tyre dhe në muzikë;
- Të dallojnë vetitë e tingullit në këngë ose në pjesë të thjeshta muzikore;

- Të dëgjojnë pjesë muzikore, duke përcaktuar karakterin e pjesëve me fjalë të thjeshta (kjo muzikë është e gëzuar sepse më bën të vallëzoj etj.);
- Të krijojnë dhe të shpjegojnë prirjet e tyre muzikore me një gjuhë të thjeshtë për këtë nivel, si dhe me mjete të arteve të tjera.

**Edukimi muzikor në klasën e parë synon të formojë nxënësit si përjetues të muzikës, duke shprehur botën emocionale nëpërmjet saj.**

## **LINJAT E PROGRAMIT**

- 1. Këndimi & lojëra muzikore**
- 2. Bazat e arsimimit muzikor**
- 3. Luajtja në instrument**
- 4. Dëgjim muzikor**
- 5. Të shprehurit dhe krijimi muzikor**

## **OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM**

Objektivat e programit do të zërthehen për çdo linjë si më poshtë:

### **LINJA I. Këndimi & lojëra muzikore**

Në këtë linjë nxënësit duhet:

- të këndojnë këngë të thjeshta për fëmijë: tematike, didaktike dhe të krahinës;
- të demostrojnë shprehitë vokale gjatë të kënduarit, si: rregullat e frymëmarrjes, qëndrimi drejt, diksioni, këndimi me ndjenjë etj;
- të shqiptojnë saktë tekstin;
- të këndojnë me intonacion të saktë;
- të këndojnë dhe të interpretojnë në mënyrë shprehëse, duke treguar se e kanë kuptuar tekstin e këngës;
- të këndojnë vetëm;
- të këndojnë në grup;
- të krijojnë efekte të veçanta tingujsh (imitimi i zërave të shokëve, të instrumenteve të ndryshme etj.), duke përdorur zërin, shuplakat, shkopinj ose instrumente;
- të përjetojnë ndjenjën ritmike dhe melodike përmes këndimit të këngëve të ndryshme;
- të ndjekin ndryshimet e ritmit (në mjedisin e tyre, në këngë apo pjesë të ndryshme fëmimore);
- të shfaqin dëshirat e tyre për këngë të ndryshme (këngë për fëmijë ose të krahinës);
- të luajnë lojëra muzikore, duke i shoqëruar me pëllëmbë ose mjete ritmike (gurë, shkopinj);

- të luajnë lojëra muzikore duke ndërthurur muzikën me lëvizjen;

**Objektiv shoqëror:**

- të respektojnë mendimin dhe dëshirat e të tjerëve për këngët.

**LINJA II. Bazat e arsimimit muzikor\***

Në këtë linjë nxënësit duhet:

- të ndjekin dhe të dallojnë ndjenjën ritmike dhe melodike tek këngët, lojërat, pjesët muzikore;
- të dallojnë tingujt nga zhurmat (i gjejnë ato në jetën e përditshme dhe t'i përcaktojnë);
- të identifikojnë shembuj të ritmit në jetën e përditshme dhe në muzikë *ngadalë – shpejt*, p.sh.: rrahja e zemrës, tik-taku i orës, rrahja e pulsit të dorës, rrahja e daulles në një marsh etj;
- të identifikojnë tingujt të ndryshëm që dëgjon në jetën e përditshme, në mjedisin e klasës dhe në muzikë: zhurma i derës, zëri i zogut, zëri i shokut etj., duke përcaktuar vetitë e tyre (i trashë, i hollë, i butë – i fortë etj.). Pra, tingull:  
*( lartësia) i lartë – i ulët,*  
*(gjatësia) i gjatë – i shkurtër,*  
*(ngjyra) i lehtë - i fortë*  
**Tempin**  
*Karakterin e një kënge, valleje, pjese muzikore;*
- të krijojnë modele ritmike, duke i imituar shembujt e mësipërm;
- të identifikojnë ritmin në të folur (p.sh., modele të tingujve të gjatë dhe të shkurtër në vargjet e një vjershë).

**LINJA III. Luajtja me instrument**

Në këtë linjë nxënësit duhet:

- të demostrojnë modele të thjeshta ritmike: rrahje me pëllëmbë, me vegla, me goditje;
- të shoqërojnë këngën me vegla ritmike apo të krijuara nga ata;
- të shoqërojnë lojërat muzikore me vegla ritmike ose duke i shoqëruar me lëvizjet trupore.

**LINJA IV. Dëgjimi muzikor**

Në këtë linjë nxënësit duhet:

- të dallojnë përmes dëgjimit zërat vokalë dhe të veçojnë dy nga karakteristikat e tyre;
- të dallojnë disa instrumente muzikore përmes dëgjimit;
- të komentojnë me fjalët e tyre muzikën që dëgjojnë (shpejt, ngadalë, rëndë, ëmbël);
- të shoqërojnë muzikën, nëpërmjet lëvizjeve të përshtatshme (duke marshuar, duke vallëzuar).

## LINJA V. Shprehje dhe krijim muzikor

Në këtë linjë nxënësit duhet:

- të gjejnë ndryshimet ndërmjet tempit (*shpejt – ngadalë*), duke dhënë shembuj që ndodhin në mjedisin e tyre dhe në muzikë;
- të përcjellin mendimet dhe emocionet e tyre rreth muzikës që dëgjojnë, përmes gjesteve, mimikës etj.;
- të përcjellin mendimet dhe emocionet e tyre rreth muzikës që dëgjojnë, përmes formave të ndryshme të artit (vizatimi, tregimi, poezia);
- të listojnë disa nga rrugët në të cilën muzika bën pjesë në jetën e tyre të përditshme (p.sh., muzika e dëgjuar në televizion, në festat familjare, në krahinë apo në vend).

### Objektiv shoqëror:

- të listojnë disa fjali, shprehje që përdorin për të shprehur marrëdhëniet e tyre me muzikën.

*\*Shënim për linjën 2. Kjo linjë do t'i japë njohuritë në një mënyrë shumë të thjeshtë dhe konkrete, duke i gjetur shembujt në mjedisin e klasës apo në pjesë të thjeshta muzikore.*

## PROGRAMI ANALITIK PËR KLASËN E PARË

35 javë x 1 orë = 35 orë

1) Këndim & lojra muzikore	20 orë
2) Bazat e arsimimit muzikor	3 orë
3) Dëgjim muzikor	2 orë
4) Luajtje në instrument	2 orë
5) Shprehje dhe krijim muzikor	1 orë
6) Në dispozicion	4 orë
	3 orë

Nr	Linjat	Temat	Veprimtaria	Mjetet	Orë
1.	Këndim	Këngë të ndryshme	Këndimi i këngëve të ndryshme që dimë.	Vegla me goditje, për shoqërimin e këngëve	1 orë
2.	Këndim + Lojëra	Lojë muzikore "Roza rozina"	Zhvillimi i ndjenjës ritmike nëpërmjet lojës muzikore, duke e kombinuar me lëvizjet e trupit.	Vegla me goditje	1 orë
3.	DM	Këngë dhe pjesë muzikore	Dëgjimi i tyre duke përcaktuar karakterin e tyre, <i>e gëzuar, vallëzuese, nina – nana</i>	Magnetofon, kaseta	1 orë

			etj. ato. <i>Nina – nana Shubert, Festa e mësuesit, muzikë vallëzuese, etj.</i>		
4.	Këndim	Kënga “Ëndrra”	Pozicioni i të kënduarit dhe rregullat e frymëmarrjes gjatë këndimit. Shqiptimi i saktë i fjalëve.	Postera me teknikat e frymëmarrjes dhe poz. e të kënduarit.	2 orë
5.	BAM	Vetitë e tingullit	Muzika në jetën e përditshme dhe në muzikë, duke veçuar tinguj <i>të ulët - të lartë, të fortë - të butë, të gjatë- të shkurtër.</i> Shembuj konkretë nga nxënësit dhe nëpërmjet dëgjimit dhe këndimit të këngëve: “ <i>Macja le të lahet</i> ” <i>gjatë- shkurt;</i> “ <i>Gabimi i Mirelës</i> ” <i>Fortë – butë, lartë -ulët</i>	Magnetofon, kasetë dhe tastierë	1 orë
6.	LI	Veglat ritmike me goditje dhe trupore	Njohja me veglat ritmike dhe shoqërimi me to i këngëve që dimë.	Gurë, shkopinj, shuplaka, triangolo.	1 orë
7.	Këndim + lojëra	Loja muzikore “Hapa dollapa”	Zhvillimi i ndjenjës ritmike dhe melodike duke gërshetuar rrahjet e duarve me muzikën dhe lëvizjet e trupit.	Magnetofoni, kasetë gurë, shkopinj.	1 orë
8.	SHKM	Të shprehim emocionet tona	Shprehja e emocioneve që krijon muzika e dëgjuar, duke e dhënë edhe nëpërmjet arteve të tjera (Brams “Nina nana)	Magnetofon, kasetë, ngjyra.	1 orë
9.	Këndim Lojë muzikore	Këndojmë dhe luajmë “Loja e shqiponjave	Luajtja me vegla të ndryshme, dhe zhvillimi i ndjenjës ritmike gjatë të kënduarit.	Lugët, shkopinj, gurët, triangolo.	1 orë
10.	Këndim	Kënga “Tik – tak një, dy”	Zhvillimi i ndjenjës ritmike të këngës, tempi dhe karakteri i saj.	Veglat popullore ose me goditje.	2 orë
11.	BAM	Ritmi	Identifikimi i ritmit në jetën e përditshme, në klasë dhe tek këngët. Shembuj të ndryshëm. Përcaktimi i karakterit të	Magnetofon, kasetë,	1 orë

			këngëve që këndojmë.		
12.	Këndim	Kënga "Ja, na erdhi Viti i Ri"	Këndimi i këngës duke shprehur qartë emocionet e festës.	Magnetofn, kaseta, shoqërim me shuplaka.	2 orë
13.	Këndim	Kënga "Qëngji i vogël"	Këndimi me ndjenjë i këngëve tona, duke respektuar dhe shoqëruar ritmiksht këngën me vegla të thjeshta ritmike.	Vegla me goditje, shkopinj, shuplaka, triangolo, gurë etj.	2 orë
14.	Këndim	Kënga "Moj bubrrec"	Tingulli <i>i gjatë- i shkurtër</i> duke e shoqëruar me vegla me goditje.	Magnetofon, kasetë, vegla me goditje.	2 orë
15.	SHKM	Të shprehësh dhe të vlerësosh	Dëgjimi dhe vlerësimi i muzikës apo këngës me një gjuhë të thjeshtë (e pëlqej këtë muzikë sepse më bën të vallëzoj), këngë ose valle me karakter të gëzueshëm.	Magnetofon, kaseta,	1 orë
16.	Këndim	Kënga "Festa e abetares"	Këndimi i këngës me gëzim dhe emocion.	Magnetofon, postera nga subjekti i këngës.	2 orë
17.	Këndim	Këngë të ndryshme	Këndimi i këngëve të ndryshme duke respektuar ritmin, rregullat e frymëmarrjes, intonacionin dhe karakterin e këngëve.	Magnetofon, vegla me goditje.	1 orë
18.	DM	Pjesë të thjeshta	Dallimi i zërave nga instrumentet. Shembuj të thjeshtë: këngë të ndryshme për fëmijë, për të rritur, "Trëndafili i vogël" T.Harapi etj.	Magnetofon, kaseta	1 orë
19.	Këndim	Kënga "Himni i Flamurit"	Njohja me Himnin kombëtar	Magnetofoni .	1 orë
20	SHKM	Shprehje dhe vlerësim	Ngjarje të ndryshme nga jeta artistike e qendrës së tij të banimit. Bisedë e lirë. Këngë të ndryshme.	Magnetofon, kaseta.	1 orë
21	Këndim	Kënga "Pa shikoni duart tona"	Këndimi i këngës duke ruajtur karakterin dhe tempin e saj.	Magnetofon.	2 orë

22	SHKM	Muzika apo kënga që më pëlqen.	Shprehja e muzikës që na pëlqen, duke sjellë shembuj nga përjetimi i një feste familjare, feste në klasë apo në shkollë.	Magnetofon, kasete.	1 orë
23	Këndim	Këngët më të bukura	Përgatitja e këngëve të ndryshme dhe lojërave duke zbatuar njohuritë e mësuara	Magnetofon, kasetë.	2 orë
24	Këndim	Zhvillimi i veprimtarisë			1 orë

**\*Shënim.** Çdo linjë e programit duhet të ndërthuret shumë mirë me veprimtarinë, e cila është në shërbim të objektivave që synon çdo linjë. Mësuesi është ai që do të organizojë dhe do të vendosë që më parë se cilat do të jenë veprimtaritë që do të ndërmarrë për dhënien sa më saktë, thjeshtë dhe kuptueshëm të elementeve muzikore duke i përshtatur ato me linjat. Gjithashtu, orët në dispozicion mund të shpërndahen gjatë vitit për të përsëritur tema të ndryshme. Mësuesi mund t'i përdorë ato për nevoja të ndryshme që mund të ketë, si: mësimi i ndonjë kënge të vështirë, përgatitja e ndonjë koncerti në klasë etj., gjithmonë në shërbim të tërësisë së kërkesave të programit mësimor.

Mësuesi mund të ndryshojë këngën, lojërat apo pjesën për dëgjim për ta zëvendësuar atë me një tjetër, në përputhje me kërkesat dhe objektivat e programit.

Kënga "Himni i Flamurit" përbën një objektiv parësor, i cili, do t'u jepet nxënësve me qëllimin e vetëm që ata të njohin himnin e tyre dhe të mundohen ta këndojnë atë bashkë me nxënësit e tjerë të shkollës në veprimtaritë e shumta që kryen shkolla.

## METODOLOGJIA E ZBATIMIT TË PROGRAMIT

### Parime të përgjithshme të metodologjisë

Një vend shumë të rëndësishëm në organizimin e orës së mësimi ka formulimi i objektivave, si dhe përcaktimi i metodave që do të përdoren për të qenë sa më i sukseshëm dhe për të arritur objektivat e orës. Përzgjedhja e metodave mësimore bëhet nga vetë mësuesi, në përputhje me veçoritë e moshës së nxënësve dhe të përmbajtjes së temave të ndryshme mësimore, të bazës materiale apo të mjeteve e instrumenteve muzikore që ka në klasë. E rëndësishme është që mësuesit të krijojnë një mjedis mësimi, i cili do t'i nxisë dhe do t'i ndihmojë nxënësit për të zbuluar dhe për të zhvilluar aftësitë dhe prirjet e tyre muzikore. Mësuesit duhet të organizojnë veprimtari praktike sa të jetë e mundshme, pasi shumë aftësi të përcaktuara në program duhet të arrihen nëpërmjet pjesëmarrjes së nxënësve në to.

Mësuesi i orienton nxënësit e klasës së parë për të përdorur modele të ndryshme ritmike apo melodike, dallimin e tingujve të muzikës dhe të zhurmave të realitetit natyral, të instrumentit muzikor apo edhe të objekteve të tjera.

Mësuesi duhet të përdorë vetë metoda sa më të frytshme, nëpërmjet të cilave bëhet e mundur asimilimi me lehtësi të të gjithë veprimtarive didaktike, si: lojërave individuale dhe në grup. Duhet të ketë parasysh zgjedhjen e pjesëve muzikore për dëgjim, të cilat duhet të ndjekin kritere të posaçme në lidhje me aftësinë psikologjike dhe shkallën e zhvillimit të njohurive të nxënësit.



Mësimi i elementeve muzikore shërben për të krijuar aftësi dhe shprehje që nxënësi i përvetëson nën drejtimin e mësuesit. Prandaj mësimdhënia e edukatës muzikore kërkon një përgatitje të mjaftueshme shkencore, pedagogjike dhe metodike. Nën drejtimin e mësuesit, nxënësit e klasës së parë do të përvetësojnë njohuritë dhe konceptet e para muzikore, me të cilat do të formojnë shprehitë për të kënduar, për të dëgjuar apo për t'u shprehur, si dhe duke u bërë një analizë të thjeshtë këngëve apo pjesëve muzikore. Niveli i dijeve, të shkathtësive e të shprehive të nxënësit përcaktohen jo vetëm nga përmbajtja e lëndës, por edhe nga zbatimi i udhëzimeve e kërkesave të veçanta që ka çdo klasë. Në klasën e parë mësohen këngë sipas veshit, në përshtatje me moshën për nga shtrirja (ambitusi) dhe nga përmbajtja, popullore dhe të kultivuara, me vlera artistike e didaktike, të karakterit femënor (natyrën, familjen, shkollën, punën, argëtimin etj.), me ritme të larmishme (vallëzues, marsh, të thjeshta, të përziera).

Këngët, e sidomos lojërat muzikore, zgjidhen në përshtatje me kërkesat e bazave të arsimimit muzikor për edukimin e ndjenjës ritmike dhe melodike. Çdo orë këndimi duhet të realizojë kërkesa të bazave të arsimimit muzikor, sepse çdo orë e e bazave të arsimimit muzikor realizohet përmes këndimit. Prandaj këndimi edhe bazat e arsimimit muzikor zhvillohen duke u ndërthurur gjatë orës mësimore.

***Shpesh, për realizimin e saktë të kërkesave të programit, mësuesi duhet të ketë parasysh disa kërkesa dhe këshilla metodike, si më poshtë:***

1. ***Edukimi i ndjenjës ritmike të nxënësve***, që mbështetet në parimin se dukuritë ritmike përjetohen në formë konkrete dhe më pas arrihet zbatimi i tyre praktik. Shembuj:

- Rikujtimi i dukurive nga natyra dhe mjedisi, p.sh.: të rrahurit e orës tik-tak, imitimi i trenit, rënia e ziles, rrahja e çekanit dhe dukuri të tjera.
- Ligjërimi i gjëzave duke i shoqëruar me lëvizje ritmike ose fjalë të ndryshme të ndara në rrokje, duke i shoqëruar me shuplaka.

Mësuesit, lidhur me zhvillimin e ndjenjës ritmike të nxënësve, të sjellin në klasë ushtrime dhe forma pune që të arrijnë të dallojnë saktë gjatësitë ritmike duke mësuar të mbajnë ose tëndojnë. Në çdo rast mësuesi duhet të ketë kujdes që të mos kalojë mundësitë perceptuese të nxënësve. Gërshetimi i ushtrimeve me elemente ritmike me shoqërimin e këngëve dhe lojërave të tyre femënore janë sa më të këshillueshme.

2. ***Edukimi i ndjenjës melodike***, që uhet të arrihet nga mësuesi nëpërmjet dëgjimeve konkrete me instrumenete, nëpërmjet magnetofonit ose duke i gjetur (konkretizuar) ato në mjedisin e klasës. Lartësia e tingujve konkretizohet më mirë jo vetëm me përfytyrime dëgjimore, or edhe ato pamore, u mësuesi mund të shkruajë në dërrasë tingujt e një kënge shumë të thjeshtë duke u treguar ndryshimin e lartësisë së tingullit.

3. ***Edukimi i shprehive të kënduarit***, që shikohet e pandarë nga aftësitë dhe shprehitë e tjera që do të formojnë nxënësin e klasës së parë dhe më tej në edukimin muzikor. Ja disa nga udhëzimet që mund të ndiqen për nxënësit e klasës së parë:

- Qëndrimi drejt gjatë të kënduarit,
- Frymëmarrja,
- Formimi i tingullit,

- Diksioni,
- Rikujtimi i kërkesave gjatë të kënduarit,
- Dhënia e intonacionit me instrument muzikor,
- Dirizhimi kur klasa këndon.

4. *Edukimin me instrumentet dhe marrëdhëniet me to*, që puna me instrumentet ka si qëllim njohjen me instrumentin gjë që u krijon lidhje më të afërta me artin muzikor. Instrumenti shton interesin për lëndën, si dhe i ndihmon drejt edukimit të ndjenjës ritmike apo melodike. Në klasën e parë mësuesit të njohin dhe të drejtojnë punën e tyre vetëm përmes veglave me goditje, të cilat zhvillojnë njëkohësisht dhe ndjenjën ritmike të nxënësve.

5. *Edukimin për zhvillimin e shprehive gjatë dëgjimit*, që dëgjimi i këngëve ose pjesëve të thjeshta muzikore zhvillon rrethin e përfytyrimeve të nxënësve jo vetëm në drejtim të muzikës, por edhe në drejtim të kulturës në tërësi (pra fillojmë të edukojmë nxënësit me dëshirën për të dëgjuar). Dëgjimi është mënyra kryesore nëpërmjet të cilit nxënësi vihet në marrëdhënie me muzikën. Nga njohuritë fillestare rreth ritmit apo tingujve, ata do të kalojnë në përjetimin e emocioneve që sjell pjesa apo kënga, deri në vlerësimin e saj. Mësuesi e kultivon ndjenjën e të dëgjuarit të nxënësit që në dëgjimin që i bëjnë ata zërit të tij gjatë këndimit të këngëve. Ai vendos për dëgjim këngë që këndohen nga grupi artistik i shkollës apo dhe nga ata vetë. Është e këshillueshme që në klasën e parë mund të dëgjohet edhe ndonjë pjesë e thjeshtë instrumentale. Mësuesi gjatë dëgjimit përdor dhe formën e bisedës, ku ai sqaron dhe shpjegon karakterin e pjesës apo edhe elemente të tjera muzikore, si: vetitë e tingullit, ritmin, tempin etj. Gjithashtu, mësuesi mund të përdorë edhe metodën e krahasimit, ku, p.sh., krahasohet një marsh me një valle, një nina-nana me një një muzikë vallëzimi etj. Për këtë:

- pjesët duhet të jenë të zgjedhura me kujdes për këtë moshë;
- dëgjimi i një pjesë të mos zgjasë më shumë se 5 minuta;
- dëgjimi i pjesëve të shoqërohet me komentimin e tyre, duke përdorur një fjalor të thjeshtë;
- dëgjimi zhvillon njëkohësisht dhe ndjenjën e komentit të pjesëve të ndryshme që ata dëgjojnë.

Gjatë punës mësimore për realizimin e objektivave të programit të edukimit muzikor, është me vlerë të zbatohen disa veprimtari të larmishme mësimore me objektiva të caktuar gjatë mësimdhënies për edukimin dhe formimin e koncepteve të para muzikore, zhvillimin e ndjenjës ritmike dhe melodike, zhvillimin e ndjenjës së dëgjimit, për zhvillimin e ndjenjës së analizës së një kënge apo pjesë të thjeshtë muzikore. Por, njëkohësisht do të jenë dhe mjetet mësimore që do të mundësonin zbatimin me sukses të këtij programi.

### **UDHËZIME PËR VLERËSIMIN E NXËNËSVE**

Vlerësimi i nxënësve në këtë lëndë do të bëhet përmes arritjeve të çdo nxënësi në veprimtari të praktike, d.m.th., përmes të kënduarit, të luajturit, të analizuarit të pjesëve muzikore etj. Në klasën e parë mësuesi vlerëson nxënësit me shprehje. Vlerësimi bëhet në atë çka nxënësi ka përvetësuar dhe është i aftë të bëjë.

Disa komponentë që çojnë në një vlerësim të saktë të nxënësve, janë:

1. Kupton elementet bazë të muzikës;

2. Përdor dhe manipulon drejt elementet bazë të muzikës gjatë këndimit, lojërave, dëgjimit, komunikimit dhe vlerësimit të pjesëve;
3. Komunikon dhe shpreh mendimet e tij rreth muzikës, si dhe elementeve përbërëse të saj.

Mësuesi mund të ketë si udhëzues për përshkrimin e nivelit të nxënësve në përfundim të klasës së parë tabelën si më poshtë vijon:

<b><u>Linja 1</u></b> <b><i>Këndim</i></b>	<b><u>Linja 2</u></b> <b><i>Bazat e arsimimit muzikor</i></b>	<b><u>Linja 3</u></b> <b><i>Luajtje në instrument</i></b>	<b><u>Linja 4</u></b> <b><i>Dëgjim muzikor</i></b>	<b><u>Linja 5</u></b> <b><i>Shprehje dhe krijim muzikor</i></b>
1. Zhvillon shprehitë e të kënduarit, ritmin, intonacionin, diksionin.	1. Përcakton karakterin e këngëve apo të pjesëve muzikore ( <i>shpejt, gëzuar, marsh</i> ) etj.	1. Krijon modele të thjeshta ritmike me gurë, shuplaka, shkopinj.	1. Dallon tingujt nga zhurmat.	1. Arrin të shpjegojë me fjalë të thjeshta karakterin e këngëve dhe emocionet që ato krijojnë tek ta.
2. Këndon me ndjenjë.	2. Identifikon shembuj të ritmit dhe të tingujve në jetën e përditshme.	2. Ndërton vegla me goditje me mjetet rrethore.	2. Përcakton zërat dhe jep disa karakteristika.	2. I përgjigjen muzikës që dëgjojnë me forma të tjera (duke vizatuar, duke treguar një ngjarje, vallëzuar etj.).
3. Këndon dhe shoqëron këngën me veglat me godije ose duke e shoqëruar me lëvizjet trupore.	3. Dallon vetitë e tingullit në këngë të thjeshta fëmimore.	3. Bashkërendon muzikën me lëvizjet trupore, duke bërë edhe shoqërimin me shuplaka	3. Dallon instrumentet nga zërat.	3. Përdor një fjalor të thjeshtë në përjetimin e muzikës.
4. Merr pjesë në analizimin e këngëve ose të pjesëve muzikore, duke respektuar edhe mendimin e të tjerëve.	4. Mban si duhet ritmin në këngë të ndryshme	4. Imiton dhe sjell shembuj të modeleve ritmike	4. Arrin të shpjegojë me fjalë të thjeshta karakterin e pjesëve të ndryshme që dëgjon.	

### **INTEGRIMI**

Ky program nxit mundësinë për ta parë muzikën në tema të veçanta të integruar me lëndë tjera.

Nxënësit do të mësojnë të zbulojnë dhe të ndërtojnë lidhjet ndërmjet muzikës dhe edukimit figurativ, edukimit fizik, gjuhës, edukatës qytetare dhe të kuptojnë rëndësinë e muzikës si burim kënaqësie dhe si mënyrë komunikimi brenda një kulture dhe me kulturat e tjera.

Nxënësit do të mësojnë se muzika është e vetme në llojin e saj, por ka pika komunikimi me të gjitha fushat e tjera të artit, p.sh., ritmi është një element që gjendet në të gjitha fushat artistike. Duke bërë krahasime ndërmjet muzikës dhe fushave të tjera të kurrikulës, nxënësit do të mësojnë të shikojnë lidhjet ndërmjet matematikës dhe muzikës ose ndërmjet gjeometrisë dhe kompozimit të një pikturë.

### **MJETET MËSIMORE**

Që programi i edukimit muzikor për klasën e parë të bëhet sa më i zbatueshëm dhe konkret si për nxënësin, ashtu edhe për mësuesin të shoqërohet me bazën e duhur materiale, mjete didaktike dhe burime të ndryshme. Libri i mësuesit dhe kasetat me materialet didaktike ( këngë, lojërat muzikore, pjesë të ndryshme për dëgjim, shembuj të llojeve të tingujve ose të ritmeve të ndryshme), janë ndër mjetet më të domosdoshme për këtë qëllim. Gjithashtu, me vlerë janë edhe mjetet me përdorim kolektiv, si: magnetofon, fizarmonikë, kasetat, postera dhe vegla me goditje (shkopinj, gurë, lugë, triangolo) etj.

### **Disa mendime për zhvillimin e veprimtarive praktike gjatë procesit mësimor:**

*Lojëra didaktike që lidhen me zhvillimin ritmik dhe melodik:*

- kërkon, dëgjon, dallon, krahason (tingujt & zhurmat);
- përcakton, imiton tinguj të ndryshëm;
- riprodhon tinguj të instrumenteve;
- imiton mësuesin duke përplasur shuplakat, gurë, shkopinj etj.;
- u përgjigjet ushtrimeve të thjeshta me bazë këngët, lojërave muzikore ritmike dhe melodike;
- riprodhon pjesë të shkurtra dhe të thjeshta muzikore;
- këndon këngë duke përdorur gjestet, ritmin, lëvizjet trupore.

*Lojëra me dëgjimin:*

- realizon vetëm dhe në grup lojëra me instrument me goditje, duke bërë ushtrime për riprodhimin e tingujve me zë;
- riprodhon një frazë ose strofë duke kontrolluar ritmin dhe intonacionin;
- shqipton saktë fjalët e këngës.

*Organizimi dhe përdorimi i mjeteve të tjera:*

- nxënësit të nxiten të krijojnë vetë kasetat me zhurma, tinguj, me zërat e shokëve etj.;
- të sjellin postera të instrumenteve, të këngëtarëve, kompozitorëve etj.;
- të krijojnë me ngjyrat duke pasur si frymëzim muzikën;
- të përdorin veglat me goditje dhe të shpjegojnë ndjesitë që u krijojnë ato;
- të sjellin informacione nga festa të ndryshme në familje, qytet, shkollë etj.

